



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	15.07.2024 <i>DI-403/02-10953</i>
Për:	Arbënesha Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës P-70705029-00468-26

Të nderuar,

Kryetari i Komunës së Gjakovës në bazë të nenit 58 pika (a) dhe (h) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 17 pika 6 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, me qëllim të formimit të Komisionit Vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

PROPOZIM - VENDIM

1. Kuvendi i Komunës të formojë Komisionin Vlerësues për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale me numër të parcelës: P-70705029-00468-26, me sipërfaqe të parcelës prej 1633 m² Zona Kadastrale Gjakovë - Qytet, së bashku me objektin me numër të njësisë 468-26-598-0, me sipërfaqe të ndërtesës 241.36 m², në pronësi të Komunës së Gjakovës.
2. Kryetari i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga ekzekutivi i Komunës, Kuvendi i Komunës propozon dy (2) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga radhët e subjekteve politike dhe një (1) anëtar nga sektori jo qeveritar.
3. Ky Komision Vlerësues ka mandat për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme komunale sipas pikës një (1) të këtij propozim vendimi.

Me respekt!